

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8 SH-2

8 52

SPIRO
DINAKU

SHKON HAKA TEK I ZOTI




8 SH - 7

52

SPIRO DINAKU

SHKON HAKA TEK I ZOTI

Tregime dhe skica humoristike



20/70

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

THONË, MORE MITRO...

Kjo festë bëhej me rastin e ardhjes në fshatin tonë të shokut Vasillaq, bir nga ky fshat, ikur këtu e njëzet e kusur vjet më parë me transferim, në një qytet të Shqipërisë së Mesme, e pastaj në Tiranë.

— Thonë, more Mitro, — foli xha Stefani, — se Vasillaqin, djalin e Nasit, e larguan nga Tirana dhe po e sjellin këtu, në fshatin e tij. Thonë, domethënë në fshatin tonë.

— Çfarë thonë, more Stefan, ai erdhi, ti thua thonë.

— Thonë, — tha prapë xha Stefani, — se e kanë larguar pa dëshirën e tij. Se thonë, ai paska qenë goxha i madh atje, mirëpo thonë...

— Këtu nuk të paskan thënë gjësendi, more Stefan. Ta paskan thënë gabim. Vasillaqi është larguar me dëshirën e tij, për të ardhur këtu, te ne, ku ka lindur dhe është rritur, ku ka gjithë farefisën e tij.

— Thonë se atje ku ke qenë, paska qenë goxha i madh, bile kaq goxha, sa paska pasur edhe automobil.

— Hej, dreq, ç'më gjeti! O po ty, o Stefan, t'u thaftë lëkura e veshit e t'u bëftë opingë, se më hëngre me këto «të thënat». Vasillaqi, more Stefan vëllai, nuk ka punuar kurrë shofer. E more vesh, e mora, thuaj.

— Thonë, more Mitro, se edhe unë e di që nuk është shofer. Po thonë se, vallahi, paska pasur automobil, ashtu si i thonë, de, në dispozicion.

— A, domethënë se edhe këtë me të thënë e paske, — i tha xha Mitroja pak i nevrikosur dhe vuri dorën në vesh. Diçka kërkonte të dëgjonte.

— Po këto saze nga bien kështu?, — pyeti xha Stefani. — Thonë, mos ka ndonjë dasmë në fshat. Mirëpo thonë se sot nuk është as e diel. Se, siç e di edhe ti, o Mitro vëllai, dasmat bëhen vetëm për të diel.

— Çfarë thonë, more Stefan? Dasmë, thotë! S'ka as dasmë dhe as gosti. Nuk e sheh se janë mbledhur dhe presin të vijë Vasillaqi?

— Mirëpo thonë se gruaja nuk i paska ardhur, o Mitro byrazeri. Se thonë, ajo na qenka denbabaden nga kasabaja.

— T'u thaftë koka më keq se të është tharë, more Stefan, hapi sytë dhe shiko! — Dhe bëri me dorë tutje, nga sheshi i fshatit, ku hidhej vallja me def e me qemane. — Nuk e sheh atë nusen që i kanë hedhur dorën vajzat e fshatit dhe e kanë vënë në mes?

— E, po, e shoh, o Mitro.

— E po tani si të thonë, o Stefan?

— Thonë, e pyesin me se erdhi dhe si erdhi xhanëm.

— T'u thaftë byreku në furrë, o Stefan. Oj,

si erdhi, thotë! Po ja, erdhi me këmbët e veta në fshatin e burrit të saj! — Dhe e zuri për dore xha Stefanin. — Hajde të bashkohemi me të tjerët dhe t'i presim si bijtë tanë që i kemi, o Stefan xhani. Hajde, të them!

— Thonë, ashtu do të bëjmë, o Mitro.

— Jo thonë, po eja përpara, se më plase!

Dhe ashtu të zënë dorë për dorë u futën në turmën e njerëzve, ku ziente kënga dhe muhabeti. Pas ca, në tribunën e ngritur enkas për këtë punë, u ngjitën disa shokë: sekretari i byrosë së Partisë të kooperativës sonë, kryetari i kooperativës, disa nga rrethi, kooperativistë të dalluar, bashkë me ta edhe Vasillaqi me nusen dhe djalin e tij të vogël. Edhe prindët e tij, xha Nasi me Dhoksinë, u ngjitën në tribunë.

— Shokë dhe shoqe... — Ishte sekretari i Partisë që filloi të fliste.

— Thonë, — tha prapë xha Stefani, — se më e udhës do të ishte sikur sekretari të thoshte në fillim shoqe dhe pastaj shokë, se është puna e atij emancipikimit.

— Jo more!, — u hodh xha Mitroja. — Ashtu-a, po jo emancipikimit, si e jaratise ti, po emancipimit, si i thuhet.

— E de, mirë, se nuk e navas dot të uruarën.

— ... Jemi mbledhur, — vazhdonte fjalën sekretari i Partisë, — në këtë gëzim për të pritur birin e fshatit tonë, shokun Vasillaq Jota, së bashku me familjen e tij. Ai, si komunist i vërtetë, la zyrën, Tiranën, nuk shikoi rehatinë personale dhe erdhi me gjithë familje këtu, në fshatin e tij, te prindët e tij, që e lindën dhe e rritën.

— Thonë, — tha xha Stefani, — se ky Vasillaqi e bëri si burrat. Jo si ca e ca që shkojnë nga e keqja në fshat dhe kalamanët i lënë në qytet. Dhe mirë thonë se asaj pune i thonë: kokën në qytet dhe këmbët në fshat.

— Ja, kështu të dua, o Stefan, — foli xha Mitroja i gëzuar, — jo me ato thonë e mos thonë.

— Thonë, të paça me ymër të gjatë, o Mitro!, — e uroi xha Stefani shokun e vet.

— Ju falem nderit për pritjen!, — filloi të fliste edhe Vasillaqi. — Kjo më mbush me gëzim dhe më shton vullnetin për punë. Mirë se ju gjeta, të dashur prindër, shokë e shoqe, miq e vëllezër!

— O po shkolla është shkollë, o Stefan! Shiko si flet djali, si bilbili në maj. Jo si ca: ngëk, ngëk; u zë pështyma fytin.

— Po të thashë që në krye të muhabetit, o Mitro, se ai kot nuk ka qenë goxha i madh atje ku ka qenë.

— Mirë se erdhe, o bir!, — e uroi xha Nasi djalin e tij dhe e përqafoi. Edhe nënë Dhoksia ashtu bëri. — Mirë se erdhe, moj nuse! Hajde, nipçe, te babagjyshi. Oh! Oh! Pëllumbi i babagjyshit, përbukuri do t'ia çojmë! — Dhe me shaminë e pastër të xhepit fshiu sytë.

— Thonë se Nasi po qan, o Mitro.

— Prapë thonë, o Stefan?

— Jo, po thonë se po qan vërtet. Pse xhanëm, ë?

— Po janë lotë gëzimi, o Stefan.

— Thonë, more Mitro, se këtu ke të drejtë ti dhe jo unë, më duket.

— Po prapë me ato të «thëna» ti, o Stefan, akoma nuk u binde?

— S'ka më ç'të thonë. Se thonë, një fshat që duket, nuk ka nevojë për kallauz.

— Prapë thonë ti?!

— Më fal, Mitro, harrova për për... për nder. Unë desha të thosha se «thonë» nuk them më.

«DASMA» E NJË TË VDEKURI

Tre vjet më parë, «në moshën më të re», plot nëntëdhjetë e pesë vjeç, duke lënë «një tufë fëmijë», më «të voglin» pesëdhjetë e tre vjeç», xha Timoja i la lamtumirën kësaj bote dhe u nis për në atë tjetrën, ku, sipas papa Jorgos, qenkësh plot rehat dhe tërë qejfe.

— Mos u largo, — më njoftoi ime shoqe në shtëpi, — se je për drekë te likoja i xha Timos. Ka tre vjetët e babait.

— Edhe këta njerëz, nuk janë në vete, — i thashë, — oj, merr burri i botës tridhjetë kile mish, dhe hajdeni, o të mençur, të hani mallin e budallait.

— Të zë e keqja, more burrë, se e kemi ngjitur edhe me shtëpi. Pastaj ata erdhën dhe morën pjata, lugë, pîrunë, sahanë, tepsira, kusira e ç'u duheshin.

— Pse nuk hap një ekspozitë Likoja me orenditë e mbledhura?

Desha, s'desha shkova dhe unë. I ngjatjetova të gjithë. Rreth tridhjetë e kusur vetë rrinin ulur këmbëturqisht në një tënëz, që Likoja e kishte

ndërtuar enkas për këtë «hall». Doni ju që, ndonëse ajo ditë ishte korrik, ndodhi e freskët. Fati i Likos dhe zemra e bardhë e të ndjerit xha Timo, ndryshe nuk kishte tjetër shpjegim, i jepnin udhë kësaj pune plakat andej nga kuzhina.

Pasi u mor aprovimi i dajës, erdhi rakia.

— Ja, mirë se na erdhët, — tha daja. — Timoja t'u ketë lënë uratën çunave, Në dasmë e në gëzime i ardhshim kësaj shtëpie. Në gëzime juve të gjithëve, që i nderuat çunat e Timos me ardhjen tuaj. Tungjatjeta tej e tej!, — tha ai dhe e rrëkëlleu pagurin e rakisë si mik të ngushtë që e kishte atë të uruar ujë tërbimi.

Pas këtij urimi shumë prekës, filluan me radhë urimet, përgëzimet dhe fryrjet e bulçive e të nofullave. Për pak kohë bisedat u prenë dhe pjatat e boshatisura u zëvendësuan nga të tjera plot e përplot. Shishet e rakisë shkonin e vinin si shtëmbat e grave kur vinin për ujë në pusin e fshatit qëmoti. Heshtjen e prishi daja, i cili tha:

— Timoja e kishte qejf këtë të shkretë. Pinte dhe bënte qejf në raki. Apo nuk ia thoshte, more, po bilbil fare!

— Ç'pyet për Timon, — foli një plak tjetër, — dyzet shëndete me raki ka ngritur në dasmën e djalit të Naunit. Na, më plaçin sytë, në ju gënjej. Ore, rrogos i bëri të gjithë. Asnjeri nuk hëngri bukë. Ai po në këmbë se në këmbë mbe-ti. Ja kështu. Epo, gëzuar!, — tha plaku. — Timos t'i vijë dheu i lehtë atje ku ka rënë. Ta kemi me nder, dolli e gani pastë ngaherë!

— Po xha Timoja ka vdekur!, — i thanë plakut. — Harreve zotrote?

— Nuk harrova; or, jo. Po ai është këtu midis nesh. Ja, mu aty ku rri kunati i tij, — domethënë e kishte fjalën për dajën e Likos, — ia dhe rakinë, e ka përpara. Ja, gëzuar, Timo! Ashtu, de. Gëzuar të gjithë, or miq, se po ju thotë Timo-ja.

